

PROTOKOLL PËR BASHKËPUNIM

NDËRMJET

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

NË FUSHËN E ARSIMIMIT DIPLOMATIK¹

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë

Duke dëshiruar të vendosin dhe të zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e arsimit diplomatik dhe përmirësimin e kualifikimit të diplomatëve, për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet shërbimeve diplomatike të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë,

Kanë rënë dakord, si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Protokollit për bashkëpunim (në tekstin e mëtejme si “Protokoll”) është të ndihmojë në krijimin e kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve. Bashkëpunimi do të bazohet në reciprocitet dhe dobi të ndërsjellë.

Neni 2

Palët do t’i japin prioritet shkëmbimit të ndërsjellë të informatave mbi çështjet arsimore, metodologjike dhe shkencore, si dhe futjen dhe elaborimin e metodave moderne dhe teknikave për trajnimin e diplomatëve dhe specialistëve në fushën e:

- politikës së jashtme;
- marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë;
- të drejtës ndërkombëtare;
- marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare;
- shkencave politike dhe disiplinave tjera;

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

- Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit në BE.

Neni 3

Bashkëpunimi sipas këtij Protokollit mund të përfshijë:

- bashkëpunimin e përbashkët në kurset bazike dhe të specializuara të trajnimeve diplomatike;
- shkëmbimin e materialeve mësimore;
- shkëmbimin e diplomatëve të rinj ose të karrierës së mesme me qëllim të përmirësimit të kualifikimeve të tyre;
- shkëmbimin e njohurive dhe përvojës përkritazi me organizimin e mësimdhënies në institucionet akademike;
- shkëmbimin e ekspertëve për pjesëmarrje në vizita studimore, trajnime, konferenca, seminare, tryeza të rrumbullakëta, simpoziume, punëtori, dhe panele diskutimi të mbajtura nga Pala tjetër;
- organizimin e kurseve të përbashkëta, seminareve, konferencave dhe simpoziumeve, zhvillimin e hulumtimeve të përbashkëta akademike në nivel bilateral dhe rajonal;
- zbatimin e projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në nivel bilateral dhe rajonal;
- organizimin e takimeve për çështjet e interesit të përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të të dyja Palëve;
- Çdo formë tjetër të bashkëpunimit që mund të vendoset bashkërisht sipas Palëve.

Neni 4

Për format, kohëzgjatjen dhe kushtet financiare të shkëmbimit dhe trajnimit të përfaqësuesve të Palëve, do të bihet dakord në mënyrë plotësuese ndërmjet Palëve.

Përveç nëse në mënyrë të ndërsjellë është rënë dakord ndryshe, secila Palë do të jetë përgjegjëse për përmbushjen e shpenzimeve të veta, të shkaktuara nga zbatimi i këtij Protokollit.

Neni 5

Ky Protokoll do jetë në fuqi nga data e nënshkrimit.

Dispozitat e këtij Protokollit mund të ndryshohen përmes pëlqimit të ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Mosmarrëveshjet dhe kontestet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e Protokollit do të zgjidhen ndërmjet Palëve përmes konsultimeve.

Secila nga Palët mund të shprehë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, dëshirën e saj për të ndërprerë zbatueshmërinë e Protokollit në datën e caktuar. Njoftimi duhet të bëhet të paktën tre muaj përpara. Çështja e programeve të papërfunduara do të zgjidhet përmes konsultimeve ndërmjet Palëve.

Bërë në Shkup, më 22 Janar 2015, në dy kopje origjinale në Gjuhën Angleze.

**Për Ministrinë e Punëve të Jashtme
të Republikës së Kosovës**

Zëvendës Kryeministër i Parë
dhe
Ministër i Punëve të Jashtme

SH.e.T. Z. Hashim THAÇI

**Për Ministrinë e Punëve të Jashtme
të Republikës së Maqedonisë**

Ministër i Punëve
të Jashtme

SH.e.T. Z. Nikola POPOSKI
